

STATUT I SHOQËRISË AKSIONERE "UJESJELLES-KANALIZIME" LUSHNJE

Neni 1 Emërtimi

Shoqëria emërohet sh.a "Ujesjelles-Kanalizime" Lushnje.

Neni 2 Sella

Sella e shoqërisë është në "Lushnje". Shoqëria mund të ushtrtojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

Neni 3

Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 4 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kompanisë është pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë here, me vendim të asamblesë së akcionarëve.

Neni 5 Objekti

Objekti i shoqërisë është: 1. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij; 2. Mirëmbajtjen e sistemit(ëve) të furnizimit me ujë të pijshëm; 3. Prodhimin dhe/ose blerjen e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve; 4. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij; 5. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastërimit të tyre. Shoqëria mundet të realizojë çdo loj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

Neni 6 Kapitulli

Kapitali themeltar i shoqërisë është 355.000.000 lekë dhe është i ndarë në 355.000 aksione me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secili. Në kapitalin e shoqërisë është përfshirë dhe trualli me vlerë 9.396.000 lekë. Kapitali i shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar tërësisht.

Neni 7 Aksionet

1. Aksionet janë të formës nominative dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. 2. Pronësi mbi aksionet rezultojnë nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit apo titullarëve në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë apo ndërmjetësve financiarë. 3. Aksionet zotërohen në masën 100% nga Bashkia Lushnje.

Neni 8 Asambleja e akcionarëve

Asambleja e akcionarëve, e zakonshme dhe e jashtëzakonshme, mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak Lushnje. Ajo thirret nga Këshilli Mbikëqyrës apo Administratori. Në mungesë ajo mund të thirret gjithashtu nga: a) eksperti kontabël i autorizuar, b) nga një mandatar mbledhje, i caktuar nga gjyqi, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent, ose c) nga likuiduesi si dhe me kërkesë të akcionarëve që zotërojnë të paktën 10% të aksioneve të shoqërisë.

Neni 9 Kompetencat e asamblesë së zakonshme

Asambleja e zakonshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar. Ajo merr vendime të vlefshme vetëm në qoftë se janë 1/2 e aksionerëve të pranishëm. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e zakonshme merr vendimin me shumicën e votave që zotërojnë akcionarët e pranishëm ose të përfaqësuar. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: a) përcaktimin e politikave tregtare; b) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

Neni 10 Kompetencat e asamblesë së jashtëzakonshme

1. Asambleja e Jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar akcionarët, që zotërojnë më shumë se 50% për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas pikës 4 të këtij neni, asambleja e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse akcionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht.

2. Nëse asambleja e Jashtëzakonshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

3. Në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, asambleja e jashtëzakonshme mund të ketë katërrat e votave të akcionarëve, që marrin pjesë në votim.

4. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, të renditura në nenin 9 të këtij statuti, me shumicën e votive të akcionarëve, që marrin pjesë.

Neni 11 Kryetari dhe sekretari i asamblesë së akcionarëve

Asambleja e akcionarëve drejtohet nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës apo në mungesë të tij nga një person i autorizuar nga kryetari. Kryetari i asamblesë asistohet nga një sekretar i emëruar nga asambleja e akcionarëve.

Neni 12 Thirrja e asamblesë së akcionarëve

Thirrja e mbledhjeve të asamblesë së akcionarëve bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim 21 ditë para mbledhjes. Njoftimi, që duhet të bjerë në dorën e akcionarëve apo të procedojë për zëvendësimin e tyre në çdo rrethë nënshkruar nga kryetari dhe sekretari të asamblesë së akcionarëve, sipas pikës 4 të këtij neni, asambleja e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse akcionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht.

Neni 13 Rendi i ditës së asamblesë së akcionarëve

Rendi i ditës i mbledhjeve të asamblesë së akcionarëve përcaktohet nga autori i lajmërimit. Megjithatë një apo disa akcionarë që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit, u njihet e drejta për të futur në rendin e ditës disa projektrezoluta. Këto projektrezoluta dërgohen në selinë e shoqërisë të shoqëruara me shkresë përcjellëse dhe me dokumentin ku vërtetohet zotërimi apo përfaqësimi i pjesës së kapitalit të kërkuar sipas paragrafit të dytë të këtij neni.

Asambleja nuk mund të shqyrtojë një çështje që nuk përcaktohet në rendin e ditës, megjithatë ajo mund të shkarkojë një ose disa anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe të procedojë për zëvendësimin e tyre në çdo rrethë nënshkruar nga kryetari dhe sekretari të asamblesë së akcionarëve, sipas pikës 4 të këtij statuti. Në rast se mbledhja e parë e asamblesë nuk realizohet, rendi i ditës i mbledhjes së asamblesë së akcionarëve të ndryshohet në lajmërimin për mbledhjen e dytë.

Neni 14 Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të sh.a. "Ujesjelles-Kanalizimeve" janë:

1. Këshilli Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 anëtarë, të cilët emërohen nga asambleja e zakonshme e akcionarëve me kandidaturat alternative të propozuara nga Kryetari Bashkiak.

Neni 16 Kohëzgjatja e mandatit të Këshillit Mbikëqyrës

1. Kohëzgjatja e mandatit të Këshillit Mbikëqyrës është 3 vjet. Ata mund të rizgjidhen. 2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata duhet të jenë në moshën minime 18 vjeç, të shpirtërisht të lirshëm, të shëndetshëm dhe të aftë për kryerjen e detyrës së punës. 3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të zgjidhur nga asambleja mund të shkarkohen në çdo moment nga kjo e fundit për shkak të përkrahjes.

4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të Mbikëqyrës, me shumicë të thjeshtë votash, sipas ligjit.

Neni 17 Zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Në rastin e vendeve bosh, që krijohen nga vdekja apo dorëheqja e një apo disa anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ky këshill mundet, për periudhën midis dy mbledhjesh të asamblesë, të bëjë emërim të përkohshme. 2. Kur numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ka zbritur nën shumicën minime ligjore, Administratori duhet të thërrasë urgjentisht mbledhjen e zakonshme të asamblesë së akcionarëve të Këshillit Mbikëqyrës. 3. Emërimet e bëra nga Këshilli Mbikëqyrës, në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, i nënshtrohen ratifikimit në mbledhjen e radhës të asamblesë së zakonshme. Në mungesë të ratifikimit, shqyrtimet e bëra dhe vendimet e marra më parë nga Këshilli Mbikëqyrës mbeten gjithmonë të vlefshme.

4. Nëse një ose disa vende të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqje të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, zëvendësimi i tyre duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga koha në të cilën vendi ka mbetur bosh. 5. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës i emëruar në zëvendësim të një anëtarit tjetër, përfundojnë mandatin e parardhësit.

Neni 18 Kufizimi i mandateve

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së sh.a "Ujesjelles-Kanalizimeve", të emëruar nga asambleja e akcionarëve, nuk mund të jenë të punësuar në këtë shoqëri. Asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të bëjë pjesë në më shumë se 2 (dy) Këshilla Mbikëqyrës të shoqërive anonime që kanë seli në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 19 Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar nga kandidaturat alternative të propozuara nga Kryetari Bashkiak, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në Këshillin Mbikëqyrës dhe mund të jenë të rizgjidhshëm. 2. Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës mbanen nga një sekretar i emëruar nga Kryetari i Bashkisë. Paga e sekretarit caktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës. 3. Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës drejtohet nga zëvendëskryetari.

Neni 20 Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet në një pak se njëherë në tre muaj dhe së bashku të miratohet intereset e shoqërisë anonime, me thirrjen e kryetarit ose, në mungesë të tij, dhe të zëvendëskryetarit. 2. Kryetari, dhe në mungesë të tij zëvendëskryetari, duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data kur Administratori ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, i paraqesin atij një kërkesë për të miratuar për këtë qëllim. 3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkesues mund të thërrasin Këshillin Mbikëqyrës duke i përcaktuar rendin e ditës. 4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë, telegram, fax ose telex. 5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës. 6. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje. 7. Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se 4 anëtarë të tij. 8. Këshilli Mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e këshillit të pranishëm në atë mbledhje.

9. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit Mbikëqyrës në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. 10. Kopje të këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari (ose në mungesë të tij zëvendëskryetari) dhe sekretari.

Neni 21 Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës emëron dhe shkarkon Administratorin e shoqërisë, kur për këtë bien dakord/votojnë pro 2/3 e anëtarëve të tij. 2. Këshilli Mbikëqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga drejtorja dhe i jep këshillë të fundit autorizimit për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga drejtorja pa autorizimin e Këshillit Mbikëqyrës. 3. Me emërimin e Administratorit Këshilli Mbikëqyrës lidh kontratë me të për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë. 4. Këshilli Mbikëqyrës autorizon Administratorin që të kryejë veprimet dhe të realizojë marrëveshjet e parashikuara në nenet 23 dhe 24 të statutit. 5. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe të kontrollë buqet të asamblesë së akcionarëve dhe të njëjtit me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmirësimin e detyrës së tij. 6. Administratori i paraqet raport Këshillit Mbikëqyrës të paktën njëherë në tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar Administratori duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikëqyrës logaritë vjetore me qëllim verifikimit dhe kontrollit. Këshilli Mbikëqyrës i propozon Asamblesë së akcionarëve lidhur me këto çështje: a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurorë, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë. b) Treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, si element bazë i vlerësimit të punës së drejtorisë së shoqërisë. c) Kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin financiar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërisë. d) Hapjen e veprimtarive ose njësive të reja dhe ndryshimin e objektivit të legjislacionit në fuqi. e) Shitjen e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. f) Marrjen e huaveve të reja dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera. g) Marjimin e shuarjes afatmesme, afatgjatë. h) Si dhe për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit "Për shoqëritë tregtare" është kompetencë e asamblesë së përgjithshme.

Neni 22 Shpërblymimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Shpërblymimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të caktohet nga asambleja e akcionarëve, sipas dispozitave përkatese ligjore apo nëligjore dhe mbulohet nga shoqëria. Shoqëria njeh gjithashtu dhe shpenzimet e bëra nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, kur këta të fundit dëgjojnë me shërbim nga vetë Këshilli Mbikëqyrës për probleme të shoqërisë.

Neni 23 Administratori

1. Shoqëria administrohet nga Administratori i cili në punën që do të kryejë mund të ndihmohet nga drejtorite që ka në vartesi. Numri dhe funksionet që do të kryejë çdo drejtor në vartesi të Sh.a Ujesjelles Kanalizime do të krijohen me vendim të Këshillit mbikëqyrës me propozimin e Kryetarit të Bashkisë. Këshilli Mbikëqyrës me propozim të Kryetarit të Bashkisë emëron dhe shkarkon titullarin e Drejtorisë. Drejtorët e drejtorive janë në vartësi të Administratorit, funksionet dhe kompetencat e këtyre Drejtorëve rregullohen me rregulloren të brendshme e cila miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës. 2. Administratori ka të drejtë të kryejë vendime të veçanta të tij t'aj një ose disa punonjësve të kompanisë, të drejtën për të kryer brenda tërësisht apo kategori veprimesh, me të drejtën e nën-delegimit. 3. Administratori është person fizik, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai mund të zgjidhet edhe jashtë të punësuarve në shoqëri. Nëse një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës emërohet Administratori, mandati i tij në Këshillin Mbikëqyrës përfundon. Ai nuk mund të jetë mbi moshën 65 vjeç. Kur administratori mbysh moshën 65 vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht nga Administratori mund të shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës për shkak të përkrahjes. Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh. Administratori mund të rremërohet. 5. Paga e Administratorit caktohet nga Këshilli Mbikëqyrës. 6. Administratori ka kompetencat të plota për të vepruar në emër të shoqërisë. 7. Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet të kryesueshëm nga aktet e nënshkruara nga Administratori edhe kur këto akte e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit kapërcen objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe veprimet me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund ta injorin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme. Klausolat e statutit që kufizojnë kompetencat e Administratorit duhet të respektohen nga të tretët. 8. Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve, duhet të nënshkruhen nga Administratori ose personi i autorizuar rregjistrisht nga ky i fundit për këto akte. 9. Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet ose me vlerë mbi 2 (dy) milion lekë bëhet me autorizim të Këshillit Mbikëqyrës. Në rastet emergjente dhe pamundësie për të mbledhur

Neni 24 Marrëveshjet që kërkojnë autorizim paraprak të Këshillit Mbikëqyrës

Marrëveshjet që kërkojnë autorizim paraprak të Këshillit Mbikëqyrës janë: 1. Të gjitha marrëveshjet që bëhen ndërmjet shoqërisë dhe Administratori apo ndonjë anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë; 2. Marrëveshjet, me të cilat një nga personat e sipërpërmendur lidhet indirekt, apo në të cilat ai lidhet me shoqërinë nëpërmjet një personi ndërmjetës;

Neni 25 Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushrohet nga 2 ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Akcionarëve me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 26 Ushttrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 27 Inventari-logaritë vjetore

1. Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe veprimtarisë së saj, në pajtim me kërkesat ligjore. 2. Në mbylljen e ushtrimit financiar, Administratori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe

Neni 28 Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit

1. Rezultati i veprimtarisë përcaktohet nga diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, pas zbritjes së amortizimeve dhe provizioneve. 2. Nga fitimet e ushtrimit, pasi të jenë zbritur, kur është rasti humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5 (pesë) % për të krijuar fondet e rezervës së domosdoshme. Kur kjo rezervë arrijn 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar nuk bëhen më heqje nga fitimet e ushtrimit.

Neni 29 Likuidimi i shoqërisë

Shoqëria prishet nëse ka mbaruar kohëzgjatja e saj ose në rast se ka shpallur falimentimin. Shoqëria likuidohet në përputhje me dispozitat ligjore për falimentimin dhe ligjeve nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare", si dhe ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit". Gjate likuidimit, emri i shoqërisë ndiqet nga shprehja "me likuidim". Ky emer si dhe emri i likuidatorit pasqyrohet në të gjitha veprimet dhe dokumentet e lëshuara nga shoqëria tek të tretët.

Neni 30 Dispozita të përgjithshme

Për çfarë nuk është shprehur në statut, referimi bëhet të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare.

PER ASAMBLENE AKSIONEREVE

KRYETARI KESHILLIT BASHKIAK

ILIRI HAXHIU

